

VENDIM
Nr.448, datë 9.7.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.70, DATË 15.2.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STATUSIN E SPITALEVE UNIVERSITARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 4 të ligjit nr.3766, datë 17.12.1963 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 5 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 2 të nenit 37 të ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.70, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, Instituti i Ftiziopneumologjisë, Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik dhe shërbimi kirurgjikal i spitalit të Durrësit janë qendra kombëtare mjekimi, arsimit dhe kërkimi, në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës.

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, Instituti i Ftiziopneumologjisë dhe Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik kryejnë edhe shërbimin spitalor skondar për Tiranën, ndërsa shërbimi kirurgjikal i spitalit të Durrësit kryen edhe shërbimin spitalor sekondar për Durrësin.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Drejtorët e spitaleve universitare dhe shefi i shërbimit kirurgjikal i spitalit të Durrësit, nëse janë mjekë, emërohen nga radhët e stafit akademik të Fakultetit të Mjekësisë.”.

3. Paragrafi i dytë i pikës 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Drejtori i Institutit të Ftiziopneumologjisë, drejtori i Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik dhe shefi i shërbimit kirurgjikal të spitalit të Durrësit emërohen nga Ministri i Shëndetësisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano